



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:236857
Datë: 06.02.2024
Numri i dokumentit: 05290741

C – IV. – 15 – 0738

Paditësi :

M D nga Prishtina e të cilin me autorizim e përfaqëson, av. B I nga Prishtina.

Kundër

E paditura :

Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55 , Prishtinë.

Objekti i çështjes : Kompensimi i pagave të pa paguara.

Për: Palët ndërgjyqëse.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, me **dt.06.02.2024**, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. PRANOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, M D nga Prishtina e paraqitur kundër të të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë – Autoritetit i Likuidimit (AL) dhe **NDRYSHOHET pjesërisht**, Vendimi, PRN097-0141 i dt.04.03.2014 i të paditurës, Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë - Autoritetit të Likuidimit (AL), dhe **OBLIGOHET**, e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë - Autoriteti i Likuidimit (AL), që paditësit, t'ia kompensoj pagat e pa paguara për periudhën kohore prej muajit Shtator deri në Dhjetor 2011 e deri me 1 Gusht të vitit 2014, dhe atë pagën mujore bruto në shumën prej 586.77 € dhe atë : për 4 pagat mujore të vitit 2011, shumën prej **2,347.08 €**, për 12 paga mujore të vitit 2012, në shumën prej **7,041.24 €** për 12 pagat mujore të vitit 2013, shumën prej **7,041.24 €**, dhe për 8 (tetë) pagat mujore të vitit 2014, shumën prej **4,697.16 €** e në shumën e përgjithshme prej **21,123,72 € (njëzetë e një mijë e një qind e njëzetë e tre euro e shtatë dhjetë e dy centë)**) si dhe shumën prej **2,112,37 € (dy mijë një qind e dymbëdhjetë euro e tri dhjetë e shtatë centë)** në emër të kamatës ligjore prej 10 %, si kërkesë aksesore për detyrimin kryesor prej **21,123,72 €** nga Ndërmarrja Shoqërore (N.SH), "Marketingu" me seli në Prishtinë (në likuidim) dhe se shuma e miratuar, përmbushet në pajtim me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit e nga shuma e kërkuar për pagat e pa paguara në shumën prej 116,180.40 € për periudhën nga 1 gusht 1999 deri më 1 Gusht 2014.

II. REFUZOHET pjesërisht si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit, M D nga Prishtina lidhur me Vendimin, PRN097-0141 i dt.04.03.2014 të Autoritetit të Likuidimit (AL) të Agjencisë së Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë e me të cilin është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara mbi shumën e pranuar nga Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh), "Marketingu" me seli në Prishtinë (në likuidim) dhe i njëjti Vendim, **VËRTETOHET pjesërisht, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**

III. PRANOHET pjesërisht si e bazuar kërkesa e paditësit, M D nga Prishtina për caktimin e shpenzimeve procedurale, **CAKTOHEN pjesërisht** shpenzimet procedurale dhe atë në emër të përpilimit të padisë, shumën 104,00 €, si dhe në emër të shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore për padi, shumën prej 30.00 € e në shumën e përgjithshme prej **134.00 € (një qind e tri dhjetë e katër)** dhe **DETYROHET**, e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë - Autoriteti i Likuidimit (AL) që paditësit, M Dnga Prishtina, t'ia kompensoj shpenzimet e pranuar procedurale në këtë çështje juridike kontestimore.

IV. REFUZOHET pjesërisht si e pa bazuar kërkesa e paditësit, M D nga Prishtina për caktimin e shpenzimeve gjyqësore, dhe atë në emër të shpenzimeve për kërkesën e drejtuar Autoritetit të Likuidimit (AL) në shumën prej 52.00 €, në emër të kërkesës për shqyrtimin e shkresave të lëndës në shumën prej 52.00 € si dhe në emër të shpenzimeve për kundërshtimin e mbrojtjes së të paditurës, AKP-së, në shumën 104,00 €.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale:

Me 16 mars 2015, paditësi, pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (DHPGJSK), ka parashtruar ankesën e ushtruar kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, PRN097-0141 dt.04.03.2014 e me të cilin është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 116,180.40 € nga Ndërmarrja Shoqërore (N.SH), "Marketingu" me seli në Prishtinë (në likuidim) dhe atë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Pala paditëse parashtresën e ka titulluar si "ankesë" mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi në bazë të nenit 35 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtresave me të cilat bëhet "nisja e procedurave" pranë Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Paditësi në padi në mes tjerash ka theksuar se posedon kontratat e punës për vitet 2000, 2001, 2002, 2004, 2006 dhe 2009 dhe se ndaj kësaj ndërmarrje shoqërore, janë vendosur masat e dhunshme që si pasojë ka pasur largimin e kundërligjshëm nga marrëdhënia e punës fillimisht udhëheqësisë së ndërmarrjes e më pastaj edhe të shumicës së punëtorëve jo serbë në ndërmarrje, se me Vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së, me dt.14 korrik 2014, ka filluar procedura e likuidimit të kësaj ndërmarrjeje dhe se Autoriteti i Likuidimit (AL), me dt.01.08.2014 pas vendimit të Bordit të AKP-së, për futjen e kësaj ndërmarrjeje në likuidim, paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës nga ana e AL-së të NSH, "Marketingu", se përfaqësuesi i paditësit, me dt.03.09.2014, ka parashtruar kërkesë në likuidim, për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën prej 01.08.1999 e deri me 01.08.2014 në shumë prej 116,180.40 €, dhe se me dt.09.03.2014, ka pranuar Vendimin e Autoritetit të Likuidimit përkatës e me anë të të cilit, kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave mbi bazën se kërkesa e paditësit, është dorëzuar me dt.03.09.2014, jashtë afatit ligjor për paraqitjen e kërkesave kreditore, dhe për arsye të parashkrimit sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Tutje paditësi ka theksuar se AL-ja i NSH, "Marketingu", nuk e ka kontestuar fare faktin se paditësi – ankuesi ishte punëtor i NSH-së në fjalë, si dhe as lartësinë e kompensimit prandaj ka

konsideruar të nevojshme të argumentojmë lidhur me të ndërsa mbrojtjen ndaj kundërshtimeve tjera po e paraqesim si më poshtë, se e paditura në mënyrë të gabuar, e ka vlerësuar se kërkesa e kreditore, është paraqitur jashtë afati ligjor të përcaktuar për paraqitjen kërkesave kreditore në likuidim, se sipas shpalljes së publikuar nga e paditura, afati i fundit për paraqitjen e kërkesave kreditore në likuidim, kundër NSh, "Marketingu" nga Prishtina, është data 03.09.2014 për vëmendjen, DHPGJSK, bashkangjitur me ankesë gjeni dëshminë për dorëzimin e kërkesës kreditore, se e paditura, se rasti kryesor i kësaj ndërmarrjeje që nga viti 1998, ishte në shfrytëzim nga OSBE (OSCE) sipas kontratës së qirasë së lidhur në vitin 1998 nga menaxhamenti i atëhershëm i ndërmarrjes, se me dt.14 prill 1989 në Gazetën Zyrtare të ish Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KSAK), është shpallur Ligji mbi Marrëdhënien e Punës (teksti i spastruar) neni 73 i këtij ligj i cili përcakton se citojmë: *"Gjatë kohës së ndërprerjes së marrëdhënies së punës që është shkaktuar pa fajin e punëtorit, punëtori gëzon të drejtën e shpërblimit të të ardhurave personale në lartësinë e përcaktuar me aktin e përgjithshëm vetëqeverisës në pajtim me marrëveshjen vetëqeverisëse"*. Për më tepër neni 65 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, nr.24 të dt.22 qershor 1984), në mënyrë identike e rregullon çështjen e shpërblimit të të ardhurave personale të punëtorëve, se si pasojë e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë gjendjes faktike, e paditura e ka zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale, në atë mënyrë që fare nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë këtë gjendje faktike por AL-ja përkatëse, ka bërë zbatimin e dispozitës ligjore të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, e cila dispozitë ligjore, si dhe vet ligji në tërësi nuk paraqet ligj të zbatueshëm në Kosovës që nga viti 1989, se një konstatim të tillë paditësi e bazën në Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji, Nr.04/L – 034) duke përfshirë dhe ligjin paraprak për AKP-në, si dhe Rregulloren e UNMIK-ut, Nr.2002/12 mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (me ndryshime), në nenin 3.1.1.13 në kuadër të përkufizimeve përcakton se Ligji mbi Ndërmarrjet, nënkupton ligjin për ndërmarrjet të RSFJ-së(77/78) i ndryshuar me dhe plotësuar me Ligjet e RSGJ-së, nr.40/89 dhe 40/90 dhe 61/90, Ligji për Ndërmarrjet (GZ 77/88) etj. se Ligji mbi Punën e Bashkuar është shpallur në Gazetën Zyrtare të RSGJ-së nr.53/76 me ndryshimet dhe plotësimet e tij, dhe se pas hyrjes së fuqi të Ligjit për Ndërmarrjet, neni 196 i tij, Ligji mbi Punën e Bashkuar pushon së aplikuari dhe se rrjedhimisht referimi i AL-së në dispozitën e nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, paraqet zbatim të gabuar të së drejtës materiale pasi që kjo dispozitë ligjore është shfuqizuar me nenin 196 të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Ndërmarrjet (GZ 40/89) dhe se praktika gjyqësore në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, në 2 (dy) raste të përfaqësuar nga i autorizuari i paditësit, ka marr qëndrim se autoritetet përkatëse të likuidimit, në mënyrë të gabuar kanë zbatuar të drejtën materiale duke e bazuar vendimin e tyre në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, e cila dispozitë ligjore nuk paraqet ligj të aplikuashëm e duke i propozuar DHPGJSK-së që të merr aktgjykim e me të cilin të miratohet në tërësi si e bazuar ankesa e paditësit dhe shfuqizohet Vendimi i AL-së, PRN097-0141 i NSh, "Marketingu" në likuidim i dt.04.03.2015, obligohet e paditura, që në emër të kompensimit të pagave për ndërprerje jo ligjore të marrëdhënies së punës, të paguaj paditësit pagat e pa paguara për periudhën kohore prej datës 01.08.1999 deri më datë 01.08.2014 në shumë të përgjithshme prej 116,2180.40 € duke përfshirë edhe kamatën e kalkuluar sipas nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në në shumë prej 10.561.86 € si dhe të obligohet e paditura që të bëjë kompensimin e shpenzimeve për përfaqësim në bazë të Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës për hartimin e kësaj ankesë në vlerë prej 104.00 euro si dhe të gjitha shpenzimet tjera deri në përfundim të procedurës e më gjerësisht si në këtë padi.

Paditësi, padisë së tij, ia ka bashkangjitur, provat në kopje të tyre, siç janë: prokura speciale për përfaqësim, kopja e ID-së së paditësit, kontratat e punës për vitet 2000, 2001, 2002, 2004, 2006, dhe vitit 2009, kopjen e Gazetës Zyrtare të R. Së Serbisë për shpalljen e Ligjit për Ndërmarrjen e Masave të Përkohshme në Ndërmarrjen Shoqërore, NSh,"Marketing" me seli në Prishtinë, kopjen e Njoftimit të AKP-së për të gjithë kreditorët dhe pronarët e ndërmarrjes, kopjen e Njoftimit të AKP-së të dt.01.08.2014 për anulimin e të gjitha kontratave të punës deri atëherë në

fuqi marrëdhënies së punës në proces të likuidimit, kopjen e Formularit të plotësuar nga paditësi për kërkesën e tij të drejtuar në AKP, kopjen e Vendimit, PRN097-0141 dt.04.03.2015 të AL-së për refuzimin e pa vlefshëm të kërkesës së parashtruar nga paditësi ndaj të paditurës, NSh "Marketingu" (në likuidim) për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 116,180.40 € dhe kopjen e letrës përcjellëse të bërë nga i autorizuari i paditësit për ish punëtorët e kësaj ndërmarrje e të drejtuar në adresë të AKP-së.

Me dt.10.01.2023, e paditura, AKP me seli në Prishtinë, ka parashtruar mbrojtje ndaj ankesës së paditësit të parashtruar kundër Vendimit, PRN097-0141 të dt.04.03.2015 të AL-së, e duke pretenduar se Vendimi i AL-së, është marrë në pajtim me nenin 36.2.2. të Shtojcës së Ligjit të, Nr.04/L – 034 për AKP-në, se elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme, se padia/ankesa e paditëses, është e pa pranueshme sepse objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin, Nr.04/L -34) paditësja nuk ka cekur se cili nen i Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në, është shkëlur nga AL-ja, se pretendimet e paditëses, janë të parashkruara sepse në nenin 36 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në, që bënë fjalë për kërkesat e pavlefshme dhe jo të rregullta, aty, parashihet se ... elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme", se neni 608 i Ligjit mbi Punën e Bashkuar (publikuar në Gazetën Zyrtare nr.53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut, parashikon që "pagesa e shumës së pagesë apo rrogës apo secilës kërkesë tjetër ne punëtorit, që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkruar për tre vjet e bazuar si më sipër, ky autoriteti Likuidimit, konstaton se kërkesa dihet të ishte paraqitur në gjykatë ose ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda 3 viteve nga momenti kur NSH-ja pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit , këtu paditësit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit, e që është tre vjet nga viti 1999, prandaj ky Autoritet i Likuidimit, ka vendos që të refuzoj këtë kërkesë si të pa vlefshme dhe i ka propozuar gjykatës që t'a refuzoj si të pa pranueshme dhe të pa bazuar të ankesën e paditësit dhe t'a vërtetoj Vendimin e Autoritetit të likuidimit në pajtim me nenin 74.4 të Ligjit nr.64/L – 086.

Paditësi, pas dërgimit të mbrojtjes së të paditurës, pas kalimit të afati të dhënë në Urdhrin e kësaj gjykate, C – IV. – 15 – 0738 të dt.13.01.2023 për të paraqitur përgjigje ndaj mbrojtjes së të paditurës, paditësi dt.25.01.2023 ka paraqitur përgjigje në mbrojtjen e të paditurës e në të cilën ka theksuar në mes tjerash se e paditura gabimisht e ka zbatuar nenin 608 i Ligjit mbi Punën e Bashkuar, dispozitë kjo e pa aplikueshëm dhe se në këtë përgjigje në mbrojtje i ka përsëritur qëndrimet e tij të cekura si në padinë/ankesën e tij si dhe bazën ligjore si dhe i ka specifikuar edhe shpenzimet procedurale në shumën prej 312.00 € e të cilat i kërkon nga e paditura dhe atë për kërkesën e drejtuar tek AL-ja në shumën prej 52,00, për shqyrtimin e shkresë të lëndës, në shumën prej 52.00, në emër të hartimit të padisë në shumën prej 104.00 €, si dhe për kundërshtimin e mbrojtjes së AKP-së, shumën prej 104.00 € e sipas numrave gjegjës tarifor sipas Odës së Avokatëve të Kosovës, e më gjerësisht si në këtë përgjigje.

E paditura, pas dërgimit të Përgjigjes së paditësit të bërë ndaj mbrojtjes së të paditurës të paraqitur në mbrojtjen – përgjigje në paditë të të paditurës, dhe atë sipas Urdhrit të kësaj gjykate, C – IV. – 15 – 0738 të dt.27.01.2023, e njëjta me dt.08.02.2023, ka paraqitur kundërpërgjigje në Përgjigjen e paditësit të bërë ndaj mbrojtjes – përgjigjes në paditë të të paditurës e në të cilën në mes tjerash ka theksuar se AL-ja në bazë të nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP në, kur e ka refuzuar si të pa vlefshme kërkesën e paditësit si dhe se kërkesa e paditëses në bazë të nenit sipas nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar, është e parashkruar e më gjerësisht si në këtë kundërpërgjigje.

Arsyetimi ligjor:

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe gjykata marr aktgjykim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Po ashtu në nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK), parashihet se: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”* derisa sipas nenit 7 par. 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se : *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

Pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe pretendimeve të palëve në procedurë, gjykata vlerësoj se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit, M D nga Prishtina, duhet pjesërisht të pranohet si e bazuar për një pjesë të saj kurse pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, duhet të refuzohet si e pabazuar.

Pranueshmëria dhe afatshmëria e kërkesës së paditësit.

Gjykata, ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqës, dhe ka konstatuar, se NSH ”Marketing” me seli në Prishtinë (në likuidim), ka hyrë në procedurë të likuidimit 14.07.2014, dhe sipas Njoftimit të AKP-së të dt.01.08.2014 për anulimin e të gjitha kontratave të punës deri atëherë në fuqi nëse ekzistojnë të tilla në mes ndërmarrjes dhe punonjësve dhe me këtë rast i ka njoftuar punëtorët për ndërprerjen e kontratave të punës, përfshirë edhe paditësit. Këtë veprim Autoriteti i Likuidimit e ka bazuar në nenin 8 të Shtojcës së Ligjit, nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP). Pala paditëse pranë Autoritetit të Likuidimit (AL), me dt.03 shtator 2014, ka parashtruar kërkesë për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 116,180.40 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSH) ”Marketingu” me seli në Prishtinë dhe se Autoriteti i Likuidimit pasi që ka bërë vlerësimin e kërkesës së parashtruar nga paditësi dhe se me vendimin, PRN097-0141 dt.04.03.2015 të AL-së, kërkesën në fjalë të paditësit, ia ka refuzuar si e pa vlefshme për shkak se është bërë jashtë afatit për dorëzimin e kërkesave derisa paditësi, pas pranimi të këtij aktvendimi në procedurën e likuidimit, pas dt.05.03.2015, ankesën kundër Vendimit, PRN097-0141 dt.04.03.2015 të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë së Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, pranë DHGJSK-së, e ka paraqitur me dt.16.03.2015, pra brenda afatit ligjor prej 30 ditëve dhe se padisë/ankesës së tij, paditësi, ia ka bashkangjitur një kopje të vendimit ndaj të cilit është ngritur kundërshtimi pra Vendimit të AL-së, PRN097-0141 të dt.04.03.2015 për N.Sh, ”Marketingu” me seli në Prishtinë (në likuidim).

Gjykata, vlerëson se padia/ankesa e paditësit, i plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe afatshëm nga dispozitat ligjore të nenit 36 dhe nenit 74 Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) lidhur me nenin 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në por se kërkesën e tij pranë AL-së në procedurën e likuidimit të NSH ”Marketingu” me seli në Prishtinë (në likuidim), e ka bërë me dt.03.2014 e që është jashtë afatit për dorëzimin e kërkesave tek Autoriteti i Likuidimit (AL).

Faktet kontestuese dhe jo kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.

Gjykata vlerëson se në mes palëve ndërgjyqëse, nuk është kontestuese se paditësi me të paditurën, NSh "Marketingu" me seli në Prishtinë (në likuidim), kanë pasur raport të marrëdhënies së punës dhe se paditësi ka pasur kontratat e punës për vitet 2000, 2001, 2002, 2004, 2006, dhe vitit 2009 por kontestuese mbetet çështja e bazës ligjore që paditësi pretendon se ka të drejtë që të kërkoj nga e paditura Ndërmarrja Shoqërore (NSH) "Marketingu" me seli në Prishtinë (në likuidim), kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën prej 01.08.1999 e deri me 01.08.2014 në prej 116,180.40 € sepse kërkesën e tij pranë AL-së në procedurën e likuidimit të NSh "Marketingu" me seli në Prishtinë (në likuidim), e ka bërë me dt.03.2014 e që është jashtë afatit për dorëzimin e kërkesave derisa shuma e një page mujore bruto është kërkuar në shumën prej 586.77 € derisa është çështje tjetër se sipas kontratave gjegjëse të punës për vitet 2000, 2001, 2002, 2004, 2006, dhe vitit 2009, paga bruto e tij ka variuar prej 500.00 € deri në 1,000.00 ish DM në muaj.

Në rastin konkret, gjykata ka konstatuar se kërkesa e paditësit, ka të bëjë me kërkesat e pa siguruara për pagat e të parapara në nenin 40 par.1 pika 1.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në e në të cilin, parashihet se : *"Në procedurat e likuidimit të gjitha kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim: ... kërkesat e pa siguruara, përfshirë Kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë"*.

Për çështjen e pagesës së pagave të një punësuari në një ndërmarrje në nenin 14 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2001/27 i dt.8 tetor 2001 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës), ka qenë e paraparë se : *"Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës"* kurse në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit), parashihet se : *"I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ..."* kurse nenin 67 të Ligjit të Punës, Nr. 03/ L-212 të dt.1 nëntor 2010, që flet për Ndërprerjen e Kontratës së Punës sipas fuqisë ligjore, aty thuhet se : *"Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet: ... 1.8. me falimentimin dhe likuidimin e ndërmarrjes"* ndërsa në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit), parashihet se : *"I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ..."*.

Gjykata vëren se kërkesa e parashtruar nga paditësi është refuzuar me vendimin e AL mbi bazën e dispozitave ligjore nga neni 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP lidhur me nenin 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar (1976), duke e konsideruar se kërkesa është parashtruar jashtë afatit të paraparë ligjor për të kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara nga NSh-ja në fjalë, si palë e paditur pasi që paditësjja, edhe në procedurë gjyqësore nuk ka arritur që të bind gjykatën se ka iniciuar procedurën gjyqësore duke ushtruar padi për kompensim nga data kur ka filluar të mos merr të ardhura nga Ndërmarrja në të cilën ka punuar dhe se gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës, kanë në dispozicion arkivat për lëndën aktive të iniciuara nga palët para vitit 1999 dhe me kërkesë të palës nxjerrin parashtrësia për të dëshmuar iniciimin e procedurave gjyqësore.

Në bazë të nenit 31 par.1 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, përcaktohet se: *"Palët, në parashtrësit e tyre me shkrim, duhet të paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të fakteve që ato palë i dinë, apo me arsye besojnë të jenë relevante apo materiale për kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin përkatës"* kurse në nenin 36 par.2 pika 1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në, parashihet se *"... elementet në vijim*

përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: ... kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme” derisa në bazë të nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar (I publikuar në Gazetën Zyrtare nr.53 të vitit 1976) dhe si ligj i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24 mbi Ligjin në Fuqi në Kosovë, parashihet se: “Pagesa e shumës së pagës apo rrogës, ose të ndonjë kërkesë tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet” e për më tepër edhe në nenin 77 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i vitit 1978 gjithashtu, parashihet afati i njëjtë kohor për parashkrimin e të gjitha kërkesave me para si rezultat i marrëdhënies së punës. Andaj gjykata pas shqyrtimit të të gjitha provave gjegjëse, dhe konstatimit të gjendje faktike, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko – civile, kërkesa e paditësit, duhet të pranohet pjesërisht si e bazuar për një pjesë të saj dhe atë për periudhën kohore prej muajit Shtator deri në muajin Dhjetor 2011 e deri në muajin Gusht të vitit 2014, dhe atë pagën mujore bruto në shumën prej 586.77 € dhe atë : për 4 pagat mujore të vitit 2011, shumën prej 2,347.08 € (4 x 586.77 € = 2,347.08 €), për 12 paga mujore të vitit 2012, në shumën prej 7,041.24 € (12 x 586.77 = 7,041.24 €) për 12 pagat mujore të vitit 20013, shumën prej 7,041.24 € (12 x 586.77 = 7,041.24 €) dhe për 8 pagat mujore të vitit 2014, shumën prej 4,697.016 € (8 x 586.77 € = 4,697.16 €) e në shumën e përgjithshme prej 21,123,72 € (2,347.08 € + 7,041.24 € + 7,041.24 € + 4,697.16 € = 21,123.72 €) derisa për një pjesë të saj, kërkesëpadia e paditësit, duhet të refuzohet pjesërisht si e pa bazuar për kompensimin e pagave të pa paguara mbi shumën e pranuar dhe për periudhën kohore prej dt.1 Gusht 1999 e deri më 1 Gusht 2011 nga Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh), “Marketingu” me seli në Prishtinë (në likuidim), dhe atë për shkak të parashkrimit të saj sepse pala paditëse, nuk ka ofruar prova se para dt.03.09.2014, t’i jetë drejtuar ndonjë gjykate apo autoriteti tjetër kompetent dhe atë brenda afati prej viteve nga momenti kur NSh-ja pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit, këtu paditësit

Gjykata vlerëson se pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit për pagat e pa paguara për periudhën kohore duke filluar prej 1 Gushti i vitit 1999 e deri në muajin Gusht të vitit 2003 nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh) “Marketingu” me seli në Prishtinë (në likuidim), është e parashkruar sepse paditësi, nuk ka ofruar prova se para dt.03.09.2014, t’i ishte drejtuar gjykatës apo te ndonjë autoritet kompetent më së voni deri 1 korrik 2002, pra brenda tre viteve nga momenti kur NSh-ja, supozohet të mos ketë përmbushur detyrimet e saj monetare ndaj paditësit, pra AL-ja me anë të Vendimit të tij, PRZ097-0141 i dt.04.03.2015 si dhe përmes mbrojtjes (Përgjigjjes së dhënë në padi) e saj, AKP-ja si ndaj rastit të ngjashëm lidhur me institutit të parashkrimit, i referohet nenit 36 par.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.03/L – 034 të AKP-së dhe nenit 608 pika 1 të Ligjit për Punën e Bashkuar (LPB) (Gazeta zyrtare e RSFJ 53/76) dhe se këtë përfundim të të paditurës, AKP-së, gjykata e konsideron si aplikim të gabuar të dispozitave ligjore, nga arsyet si në vijim. Sipas nenit 608 në paragrafin 2 të LPB-së, parashihet se : “Në parashkrimin e kërkesave sipas pikës 1 të këtij neni në mënyrë të ngjashme aplikohen rregullat e përgjithshme mbi parashkrimin e kërkesave, në rastet kur ato kërkesa parashkruhen për tri vite”.

Përkitazi me çështjen e parashkrimit, në nenin 360 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), GZ e RSFJ-së, Nr.29/1978 e që flet për Rregullat e përgjithshme të parashkrimit, aty, parashihet se : “Me parashkrimin pushon e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. Parashkrimi lind kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit. Gjykata nuk mund të përfillë parashkrimin në qoftë se debitori nuk e ka invokuar atë”. Për më tepër për kërkesat periodike, siç është në rastin konkret, bëhet fjalë në nenin 372 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), GZ e RSFJ-së,

Nr.29/1978, që bënë fjalë për kërkesa periodike, aty thuhet se : “Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike) si

kur është fjala për kërkesat periodike aksesore, sikundër është kërkesa e kamatës, ashtu edhe kur është fjala për kërkesën periodike të atilla ... parashkruhen tre vjet nga rrjedhja e secilës dhënie të veçantë për pagesë''. Në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesat për pa gat e pa paguara e të cilat kanë natyrë periodike dhe këto kërkesa parashkruhen në afatin prej tre vjetëve nga rrjedhja e secilës dhënie të veçantë për pagesë. Po ashtu dispozitë të ngjashme ka edhe në nenin 353 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), Nr.04/L-077 të dt.10 maj 2012, që flet për kërkesat periodike e në të cilin, thuhet se : *''Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike) ''*.

Përkitazi me ndërprerjen e parashkrimit, në nenin 388 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), GZ e RSFJ-së, Nr.29/1978, flitet për ndërprerjen e parashkrimit, e ku është përcaktuar se: *''Parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës''*. Derisa dispozitë të ngjashme për ndërprerjen e parashkrimit për shkak të ngritjes së padisë, ka edhe neni 369 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), nr.04/L-077, e në të cilin, thuhet se : *''Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës''*. Pra, me paraqitjen e kërkesës kreditore me dt.3 Shtator 2014 nga paditësi në procedurën e likuidimit, pranë AL-së, si autoritet kompetent për shqyrtimin e saj, si dhe me njoftimin e dt.01.08.2014 për përfundimin e punësimit të paditësit tek NSh-ja në fjalë, është ndërprerë afati i parashkrimit për një pjesë të detyrimit në të holla por jo edhe për pjesën tjetër të tij sepse paditësi, nuk ka prova se para dt.3 Shtator 2014, t'i jetë drejtuar qoftë gjykatës apo ndonjë autoritet kompetent më së voni deri 1 korrik 2002 për realizimin e kërkesës së tij për periudhën kohore prej 1 Gusht 1999, pra brenda tre viteve nga momenti kur NSh-ja, supozohet të mos ia ketë përmbushur detyrimet e saj monetare ndaj tij, si paditës.

Gjykata gjen se për periudhën kohore kur paditësi, me dt.03.09.2014, i është drejtuar AKP-së (AL) si dhe njoftimit të dt.1.08.2014 të AKP-së të dërguar në adresë të paditësit për përfundimin e punësimit tek NSh-ja në fjalë, nuk mund të ecin afatet e parashkrimit por se kërkesa e paditësit për pagat e pa paguara për periudhën kohore prej dt.1 Gusht1999 e deri në muajin Gusht 2011, paditësit, i është e parashkruar derisa pjesa e pagave të pa paguara për periudhën kohore duke filluar për 4 (katër) muajt e vitit 2011, për 12 muajt e vitit 2012, 12 muajt e vitit 2013 si dhe për 8 muajt e vitit 2014, nuk i është parashkruar dhe se pranimin e pjesës së kërkesëpadisë së paditësit, në shumën prej 21,123.72 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh) *''Marketingu''* me seli në Prishtinë (në likuidim), gjykata e konsideron të arsyeshme dhe e konsideron si të drejtë dhe se ky qëndrim i kësaj gjykate bazohet në dispozitat nga neni 40.1.7 të Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në, që në mënyrë taksative, citon se : *'' ... Kërkesat e pa siguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë''* dhe se këto kërkesa dhe interesa të kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 nga i njëjtit nen 40, po ashtu të Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në si dhe nenit 55 par.1 të Ligjit të Punës, Nr.03/L-212 derisa pjesa tjetër e kërkesëpadisë së tij mbi shumën e pranuar dhe për periudhën kohore 1 korrik 1999 e deri me Gusht 2011, kjo kërkesë e paditësit, është e parashkruar sepse paditësi, nuk ka ofruar prova se para dt.3.09.2014, t'i ishte drejtuar qoftë gjykatës apo te ndonjë autoritet kompetent e më së voni deri 1 korrik 2002 për realizimin e kërkesës së tij, pra brenda tre viteve nga momenti kur NSh-ja, supozohet të mos ia ketë përmbushur detyrimet e saj monetare ndaj tij, si paditës pasi që këto kërkesa, kanë natyrë periodike dhe parashkruhen në afatin 3 (tre) vjeçar të tyre .

Gjykata po ashtu duke vepruar në bazë të dispozitave nga neni 37 par.3 të Shtojcës së Ligjit nr.04L-034 për AKP-në, paditësit, përpos kërkesën kryesore në shumën prej 21,123.72 €, ia ka pranuar edhe pjesën e saj në emër të kamatës ligjore prej 10 %, si kërkesë aksesore për detyrimin kryesor në të holla prej 2,112,37 € sepse në këtë nen, citohet se *''Të gjitha Kërkesat e bëra ndaj*

Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore”.

Vlerësimet përfundimtare të çështjes nga ana e gjykatës

Gjykata pas shqyrtimit të të gjitha provave, që gjenden në shkresat e lëndës, vlerësimi të tyre, konstatimit të gjendjes faktike, ka gjetur se pjesërisht nuk qëndron pretendimi i të paditurës, AKP-së, se kërkesa e paditësit për pagat e pa paguara për një periudhë kohore, është kërkesë e parashkruar sepse me njoftimin e dt.01.08.2014 për përfundimin e punësimit të paditësit tek NSH-ja në fjalë, është ndërprerë afati i parashkrimit për një pjesë të detyrimit në të holla por jo edhe për pjesën tjetër të tij sepse paditësi, nuk ka prova se para dt.3 Shtator 2014, t'i jetë drejtuar qoftë gjykatës apo ndonjë autoritet kompetent më së voni deri 1 korrik 2002 për realizimin e kërkesës së tij për periudhën kohore prej 1 Gusht 1999 e deri në muajin Gusht të vitit 2011, pra brenda tre viteve nga momenti kur NSH-ja, supozohet të mos ia ketë përmbushur detyrimet e saj monetare ndaj tij, si paditës derisa paditësi me bërjen e kërkesës tek AL-ja dt.03.09.2014 në procedurën e likuidimit, me këtë veprim, e ka ruajtur të drejtën që të kërkoj kompensimin e pagave brenda afatit të paraparë ligjor kurse qëndron pretendimi i të paditurës, AKP-së se një pjesë të kërkesës së tij për pagat e pa paguara dhe mbi shumën e pranuar, është e parashkruar pasi që kërkesa nga ana e paditësit, është dashur që të paraqitet në gjykatë apo ndonjë autoriteti kompetent brenda tre vjetëve, nga momenti kur NSH-ja, pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit, këtu paditësit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, pra më së voni tre vite nga dt.1 Korrik 2002, dhe punonjësve aktiv iu ndërpre marrëdhënia e punës me Njoftimin e saj të dt.01.08.2014, dhe atë në shumën e refuzuar të saj nga Ndërmarrja Shoqërore (NSH) "Marketingu" me seli në Prishtinë (në likuidim), siç parashihet me nenin 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në sepse paditësi deri më datën 01.08.2014, ka qenë në punëtor i Ndërmarrjes Shoqërore (NSH) në fjalë, si dhe si datë e pushimit të marrëdhënies së punës, ka qenë dt.01.08.2014 dhe se te Ndërmarrja Shoqërore (NSH) "Marketingu" me seli në Prishtinë (në likuidim), ka pasur përvojën gjegjëse të punës, dhe sipas kërkesës së drejtuar AKP-së përmes Formularit të plotësuar, shuma e një page mujore bruto, ka qenë 586.77 € derisa është çështje tjetër se sipas kontratave gjegjëse të puna paga bruto e tij ka variuar prej 500.00 € deri në 1,000.00 DEM në muaj. Andaj gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko – kontestimore, kërkesëpadia e paditësit, M D nga Prishtina, është pjesërisht e bazuar për një pjesë të kërkesëpadiës së tij dhe Vendimi i Autoritetit të Likuidimit (AL), PRZ097-0141 i dt.04.03.2015, duhet të ndryshohet si dhe të detyrohet e paditura, AKP-ja me seli në Prishtinë – Ndërmarrja Shoqërore (NSH), "Marketingu" me seli në Prishtinë (në likuidim), dhe që paditësit, duhet t'ia kompensoj shumën prej 21,123,72 € në emër të pagave të pa paguara për periudhën kohore prej muajt Shtator 2011 e deri në muajin Gusht të vitit 2014 si dhe në emër të kamatës ligjore prej 10 %, në shumën prej 2,112,37 €, si kërkesë aksesore për detyrimin kryesor prej 21,123,72 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSH), "Marketingu" me seli në Prishtinë (në likuidim) e nga shuma totale e kërkuar për pagat e pa paguara në shumën prej 116,180.40 € për periudhën nga 1 gusht 1999 deri më 1 Gusht 2014 derisa për pjesën tjetër të kërkesëpadiës së paditësit, mbi shumën e pranuar, e refuzoj pjesërisht si të pabazuar dhe për periudhën kohore prej 1 Korrik 1999 e deri në muajin GUAHT 2014, Vendimin e AL-së, PRZ097-0141 i dt.04.03.2015 për Ndërmarrjen Shoqërore (NSH) "Marketingu" me seli në Prishtinë (në likuidim), e vërtetoj pjesërisht si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Përfundimisht gjykata ka konstatuar se në rastin konkret pala kundërshtare gabimisht ka vepruar duke zbatuar dispozitën ligjore të cituara me lartë dhe bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe në pajtim me dispozitën gjegjëse ligjore.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, nenit 54 par.1 dhe nenit 74 par.4 të Ligjit nr.06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) lidhur me nenin 153, 159, 190, dhe nenit 197 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62 par.4 lidhur me nenin 63 parë 1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe Udhëzimit administrativ Nr. 01/2017 të KGJK-së për Unifikimin e Taksave Gjyqësore përkatësisht nenit 13.3 dhe 13.9, të këtij Udhëzimi dhe lidhur me nenin 449 dhe nenin 463 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e që pala e paditur, duhet t'i bart pjesërisht shpenzimet gjyqësore sepse në bazë të nenit 62 par.4 të Ligjit nr.06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), është përcaktuar se vetëm palës së suksesshme në procedurë (palës që e fiton gjykimin), i takon kompensimi i shpenzimeve gjyqësore dhe se paditësi, në rastin konkret, është i përfaqësuar nga avokati dhe se në këtë çështje kontestimore, pala paditëse, e ka fituar pjesërisht procesin gjyqësor, dhe për një pjesë të shpenzimeve të kërkuara, gjykata e bërë caktimin e tyre për shkak se caktimi i kësaj pjese është i bazuar kurse për një pjesë të tyre e refuzoj pjesërisht caktimin e tyre për shkak të pa bazueshmërisë së tyre, andaj gjykata ka vendosur që pala e paditur si palë në procedurë, t'i bart shpenzimet gjyqësore në këtë çështje juridike kontestimore.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, 33, 35, 36, 42, 54, dhe nenit 74 të Ligjit nr.06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS **2022:236857, 06.02.2024**

Gjykatësi
Agron Hoxhaj

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).